

Cila është kisha e Dhjatës së Re?

Të jetuarit me përgjegjësi në këtë botë kërkon medoemos marrjen e vendimeve. Madje mund të themi se jeta, po të thjeshtohet, përbëhet nga koha dhe marrja e vendimeve.

Shumica e vendimeve tona janë të vogla, të momentit dhe disi të parëndësishme. Ato ndikojnë jetën tonë për një kohë të shkurtër dhe pastaj harrohen. Vendime të tjera janë me influencë dhe vendimtare. Këto vendime hedhin hije në jetën tonë dhe e influencojnë atë jo vetëm sot, por gjithashtu edhe në të ardhmen. Ato ose do të na ndihmojnë, ose do të na dëmtojnë me kalimin e kohës. Si rrjedhim, një vendim të rëndësishëm, por të marrë pa kujdes, do ta kujtojmë gjithë jetën me një ndjenjë keqardhjeje dhe pendese.

Shpesh, ndodh të marrim vendime me nxitim dhe pa u menduar shumë dhe reagimi ynë është kaq i shpejtë, sa që duket më shumë si një përgjigje instiktive se sa një veprim i menduar mirë. E vërteta është se ne nuk i peshojmë mirë në mendje këto vendime. Vendime të tjera kërkojnë të menduar të thellë dhe analizë të kujdesshme të fakteve dhe mund të kalojnë javë apo muaj përpara se të arrijmë në një vendim përfundimtar.

Disa vendime janë kaq të rëndësishme sa ato ndikojnë

mënyrën e të jetuarit para Perëndisë në këtë jetë dhe vendosin për fatin tonë të përjetshëm. Përpara se të marrim vendime të tilla që ndikojnë jetën tonë dhe fatin tonë të përjetshëm, duhet të mendojmë seriozisht dhe të kërkojmë këshillën e Perëndisë me anë të lutjeve të vazhdueshme.

Këto të vërteta për marrjen e vendimeve na kujtojnë se ndoshta asnjë vendim i plotë nuk mund të merret përpara se të vendosim se «Cila është kisha e Testamentit të Ri?» Vendimi që marrim në lidhje me këtë pyetje, do të influencojë jetesën tonë të përditshme për Perëndinë, identitetin tonë shpirtëror, nderimin dhe shërbimin tonë shpirtëror. Kjo pyetje duhet konsideruar me vëmendje, derisa të gjejë përgjigje sipas mësimëve të qarta të Shkrimeve dhe arsyes tonë më të mirë dhe pa paragjykim.

Bota jonë është mbushur me kisha të ndryshme të cilat kërkojnë dedikimin dhe besnikërinë tonë. Një vendim duhet marrë. Cila është kisha e Testamentit të Ri? Si do të vendosim?

Duhet të shqyrtojmë faktet në mënyrë të logjikshme dhe të marrim një vendim që do të kënaqë Perëndinë. Në qoftë se ndjekim këto udhëzime me integritet, mund ta identifikojmë kishën e Testamentit të Ri sot në botë.

Cilat janë këto udhëzime?

SHIKONI FILLIMIN E SAJ

Një nga shenjat identifikuese të kishës së Testamentit të Ri është koha e fillimit të saj. Çdo kishë që fillon në një kohë të ndryshme nga kisha e Testamentit të Ri natyrisht nuk është kisha e Testamentit të Ri.

Afër fundit të misionit të Tij personal, Jezusi tha: «Unë do të ndërtoj kishën Time» (Mateu 16:18). Ai e plotësoi premtimin e Tij në Ditën e parë të Rrëshajëve pas ringjalljes së Tij (Veprat 2:41–47). Nga kjo Ditë e Rrëshajëve dhe më tej, kisha është përmendur si diçka në ekzistencë gjatë pjesës tjetër të Testamentit të Ri (Veprat 5:11, 7:38, 8:1, 3).

Supozoni se dikush thotë: «Kisha ime filloi në Testamentin e Vjetër.» Kisha e tij është shumë e hershme. Testamenti i Vjetër predikon ardhjen e mbretërisë, por nuk përmend themelimin e saj. Supozoni se dikush thotë: «Kisha ime filloi gjatë shekullit të tretë A.D.» Kisha e tij është shumë e vonshme. Kjo nuk mund të jetë kisha e Testamentit të Ri. Testamenti i Ri nuk përfundon duke na lënë në pritje për themelimin e kishës ndonjë ditë në të ardhmen. Por në të kundërt, Testamenti i Ri përfundon me Perandorinë Romake që dridhej nga përhapja e fuqishme e kishës në të gjithë botën.

Në përgjithësi, kishat Protestante u krijuan gjatë shekullit të gjashtëmbëdhjetë, gjatë apo pas Lëvizjes Reformuese. Asnjë ndarje fetare e ndonjë lloji nuk është gjetur në Testamentin e Ri. Kisha e Testamentit të Ri ishte themeluar dhe, kur shekuj më vonë, njerëzit filluan të largohen nga mësimet e Testamentit të Ri, ndarjet fetare u formuan. Pamja në Testamentin e Ri është ajo e njerëzve që bëhen kristianë, jetojnë dhe nderojnë si trupi i Krishtit shumë më përpara se të krijohej ndonjë ndarje fetare.

Kur shqyrtoni ndonjë kishë të veçantë, pyesni: «Kur filloi ajo?» Në qoftë se fillimi i saj nuk është Dita e Rrëshajëve pas ringjalljes së Zotit tonë, atëhere ajo nuk mund të jetë kisha e Testamentit të Ri.

SHQYRTONI QËLLIMIN E SAJ

Një karakteristikë tjetër identifikuese e kishës së Testamentit të Ri është qëllimi i saj. Kisha e Testamentit të Ri nuk ka ndonjë synim tjetër në këtë botë përveç synimit për të qenë kisha për të cilën flet Testamenti e Ri. Ajo nuk kërkon që të jetë e ngjashme me të apo e afërt me të. Synimi i saj është të jetë vetëm si kisha e Testamentit të Ri!

Kur mendoni për pyetjen: «Cila është kisha e Testamentit të Ri?», mund të pyesni për një kishë të caktuar: «Cili është synimi apo qëllimi i saj në këtë botë?» Kisha e Testamentit

të Ri është trupi i Krishtit në botë. Pali tha: «Kështu edhe ne, megjithse jemi shumë, jemi një trup në Krishtin dhe secili jemi gjymtyrë të njëri-tjetrit» (Romakëve 12:5). Çdo kishë që nuk kërkon të jetë trupi i Krishtit në tërësinë e saj, nuk është kisha e Testamentit të Ri.

Trupi i Krishtit në Testamentin e Ri nuk mund të përbëhej nga ndarje fetare, sepse ndarjet fetare nuk ekzistonin në shekullin e parë. Por trupi ishte i përbërë nga individë kristianë që kishin hyrë në atë trup përmes besimit të Jezusi (Veprat 16:31), pendimit (Veprat 2:38), pranimit të Jezusit si Biri i Perëndisë dhe Zot (Romakëve 10:10) dhe pagëzimit për faljen e mëkateve (Veprave 22:16). Si trupi i Krishtit, ata takohen së bashku për adhurim dhe bashkësi në vendet ku ata jetojnë (Veprat 2:42). Këta kristianë nuk ishin veçse trupi i Krishtit. Ata nuk thirrreshin me ndonjë emër tjetër. Ata ishin thjesht trupi i Krishtit, kisha e Krishtit (Romakëve 16:16). Ata nderonin së bashku, kujdeseshin për njëri-tjetrin dhe bënë së bashku punën e Perëndisë me një unitet që është ilustruar nga uniteti që gjendet midis pjesëve të trupit të njeriut.

Krishti nuk i thirri njerëzit për të qenë dishepuj të Tij përmes ndonjë ndarjeje fetare. Ai i thirri ata për të qenë dishepujt e Tij duke qenë trupi i Tij në botë. Ky trup duhet të mbajë emrin e Tij, të nderojë së bashku në emrin e Tij dhe të bëjë punën e Tij në botë për lavdinë e Tij.

SHQYRTONI VEPRIMET E SAJ

Një shenjë tjetër identifikuese e kishës së Testamentit të Ri janë veprimet e saj. Të shpallësh vetëm me fjalë se një kishë ndjek modelin e dhënë në Testamentin e Ri, nuk mjafton. Ajo kishë duhet ta provojë këtë me anë të veprimeve të saj. Çdo njeri mund të pretendojë se është kisha e Testamentit të Ri, por veprat e tij janë gjithmonë prova më e mirë për atë pretendim.

Praktikat e kishës së Testamentit të Ri mund t'i gjejmë

qartësisht të përshkruara në Testamentin e Ri. Kisha e Testamentit të Ri takohej për nderim në ditën e parë të javës dhe thyente bukën, në kujtim të vdekjes së Krishtit. E përsërisim, kjo bëhej në ditën e parë të çdo jave (Veprat 20:7; 1 Korintasve 11:20; Hebrenjve 10:25). Kristianët këndonin së bashku, duke bërë melodi në zemrat e tyre dhe duke forcuar njëri-tjetrin. Testamenti i Ri nuk tregon se ata përdornin instrumente muzikorë në adhurimin e tyre dhe as që jep ndonjë urdhër për përdorimin e tyre (Efesianëve 5:19; Kolosianëve 3:16). Ata jepnin pjesë nga zotërimet e tyre materiale në ditën e parë të çdo jave për të vazhduar punën e Perëndisë dhe për të ndihmuar të varfërit (1 Korintasve 16:1–2). Ata luteshin së bashku dhe diskutonin vullnetin e Perëndisë që ishte shfaqur nga njerëzit e frymëzuar (Veprat 2:42). Çdo bashkësi e kishës së Testamentit të Ri qeverisej vetë me anë të peshkopëve¹ apo më të vjetërve (1 Timoteut 3:1–7), duke pasur Jezusin si kreun e vetëm të kishës. Dhjakët apo shërbëtorët (1 Timoteut 3:8–11) dhe ungjilltarët (2 Timoteut 4:1–2) i shërbenin kishës nën kujdesin e më të vjetërve.

Imagjinoni sikur të kisha disa biçikleta përpara shtëpisë sime dhe sikur të kisha vendosur t’ju ofroja njëren prej tyre, në se do të mund të gjenit se cilën kisha vendosur t’ju jepja. Menjëherë do të pyesnit: «Cilat janë karakteristikat e saj?» që të mund ta gjenit atë. Në qoftë se unë do të thoja: «Ajo ka ngjyrë të kuqe, ka përpara një shportë metalike me gjashtë mollë dhe ka dy sinjale të kuq mbrapa saj», ju do të dinit me saktësi se çfarë duhet të bënit. Ju do të shkonit jashtë dhe, duke i parë biçikletat një nga një, do të përpiqeshit të gjenit biçikletën që unë përshkrova. Pasi ta gjenit atë, do të pretendonit që biçikleta është juaja tani, për arsye të marrëveshjes që ne bëmë.

A nuk është detyra jonë e njëjtë sot për të identifikuar kishën e Testamentit të Ri? Ne duhet të rreshtojmë praktikatat që karakterizojnë kishën e Testamentit të Ri dhe pastaj ta

krahasojmë këtë listë me praktikat e kishave që janë rreth nesh. Kur të gjejmë kishën që korrespondon me karakteristikat e vërteta, atë kishë që ndjek modelin e Testamentit të Ri, atëhere kemi gjetur kishën e Testamentit të Ri, kishën e Perëndisë.

SHQYRTONI EMËRTIMET E SAJ

Një shenjë tjetër dalluese e kishës së Testamentit të Ri është emri që mban. Frazat përshkruese që janë përdorur për kishën e Testamentit të Ri në Bibël, e veçojnë atë nga ndarjet fetare.

Kisha e Testamentit të Ri përmendet në Testamentin e Ri si «trup i Krishtit» (Efesianëve 4:12), «kisha e Perëndisë» (1 Korintasve 1:2), «kishat e Krishtit» (Romakëve 16:16), «kisha e të parëlindurve» (Hebrenjve 12:23), «mbretëria e qiellit» (Mateu 16:19) dhe thjesht «kisha» (Efesianëve 1:22). Këto fraza përshkruajnë natyrën dhe identitetin e kishës. Ato janë më shumë përshkrime se sa emra.

Si do ta konsideroni ju një kishë që mban një emër që nuk gjendet në Testamentin e Ri? Me siguri ne duhet të konkludojmë se kjo është e papranueshme. Së pari, në qoftë se kjo kishë është kishë e Testamentit të Ri, atëhere pse përdor për veten e saj një emër që nuk gjendet në Testamentin e Ri? Së dyti, në qoftë se kjo është kisha e Testamentit të Ri, pse nuk përdor për emër një frazë të përdorur në Testamentin e Ri për kishën, për t'u treguar të gjithëve se është kisha e Testamentit të Ri?

Së treti, mund të ndodhë që një kishë përdor një emër tjetër që nuk gjendet në Testamentin e Ri, sepse nuk mendon seriozisht për të. Deri këtu jemi në rregull. Por, nëse atyre u tregohet me fakte nga Testamenti i Ri që kjo nuk është biblike, ata me gëzim duhet ta ndryshojnë emrin dhe kështu asnjë s' do t'i ngatërrojë ata me ndonjë kishë që s'është e Testamentit të Ri.

Emrat janë të rëndësishëm. Ata identifikojnë dhe veçojnë. Është e vërtetë se një trëndafil me një emër tjetër prapë është trëndafil, ashtu si Shekspiri sugjeroi. Sidoqoftë, në qoftë se një zambak do të donte të kthehej në një trëndafil dhe do të donte që çdo njeri ta dinte se ishte bërë trëndafil, jo vetëm që do të donte të merrte karakteristikat e një trëndafili, por gjithashtu do të donte ta quante veten trëndafil. Në qoftë se një zambak do të donte të bëhej trëndafil, të zhvillonte karakteristikat e trëndafilit dhe do të donte që çdo njeri ta konsideronte si trëndafil, nuk do të kishte kuptim që ta quante veten luledielli.

E njëjta gjë ndodh me kishën. Në qoftë se kisha do që të jetë kisha e Testamentit të Ri, të zhvillojë karakteristikat e kishës së Testamentit të Ri dhe do që çdo njeri ta njohë se ajo është kisha e Testamentit të Ri, ajo duhet të përdorë për veten e saj emrat e dhënë në Testamentin e Ri për kishën e Testamentit të Ri dhe vetëm këta emra.

KONKLUZIONI

Me anë të hirit të Perëndisë, kërkimtari i ndershëm i të vërtetës mund ta identifikojë kishën e Testamentit të Ri në botë sot. Katër karakteristika të kishës së Perëndisë që ndihmojnë në mënyrë të veçantë për identifikimin e saj janë këto: (1) fillimet e saj, (2) qëllimi i saj, (3) praktikat e saj dhe (4) emrat e saj. Kur i mbajmë parasysh këto karakteristika, ndërsa kërkojmë për kishën e Testamentit të Ri, mund të dallojmë me lehtësi kishën e vërtetë nga e kisha e rreme.

Duke ecur nëpër korridorin e mbushur me njerëz, në ndërtesën që jap mësim çdo ditë, dëgjova një student të thoshte: «Vëlla Cloer, prit pak!» Ndalova, u ktheva dhe pashë një student që po nxitonte drejt meje. Megjithëse ndodhesha në mes të korridorit të mbushur plot me studentë dhe profesorë, ky student arriti të më dallojë nga njerëzit e tjerë rreth meje. Por, si arriti të më dallojë në mes të një

turme aq të madhe? Të gjithë ne kemi tipare dhe karakteristika të veçanta, të cilat na bëjnë të jemi ndryshe nga çdo njeri tjetër. Tiparet tona të fytyrës, ndërtimi i trupit tonë, sjelljet tona, zëri ynë dhe shumë tipare të tjera përfshihen në karakteristikat tona të veçanta. Ne jemi ndryshe nga çdo njeri tjetër dhe çdo njeri që na shikon, e dallon ndryshimin.

Përmes karakteristikave të saj të veçanta, kisha e Testamentit të Ri dallohet nga gjithë kishat e krijuara nga njeriu në botë. Kur shikojmë tiparet e saj të veçanta, jemi në gjendje që nga ato tipare të dallojmë kishën e Perëndisë. Sidoqoftë, kjo do të kërkojë analizimin e fakteve, krahasimin pa paragjykime të tyre dhe bërjen e pyetjeve të duhura.

A duhet të zgjedhim ndonjë gjë tjetër përveç se kishën e Testamentit të Ri? Kush do të donte ta bënte një gjë të tillë? Pse të zgjedhim të jemi një kopje e rreme, kur mund të jemi të njësuar me origjinalin?

SHËNIME

¹ Në gjuhën origjinale kjo fjalë ka kuptimin «mbikëqyrës» dhe nuk ka asgjë që të mund ta bëjë atë një autoritet që me forcë mund t'u imponohet të tjerëve.

PËRGJIGJUNI PYETJEVE

(përgjigjet në mësimin “Shtojca 1”)

1. Pse është e rëndësishme të njohim se cila është kisha e Testamentit të Ri?
2. Përmendni vargjet nga Bibla të cilat tregojnë se kisha e Testamentit të Ri filloi në Ditën e Rrëshajëve, si tregohet te Veprat 2.
3. Kur filluan ndarjet fetare?
4. Cili është qëllimi apo synimi i kishës së Testamentit të Ri?
5. Kush e përbën trupin e Krishtit, individët kristianë apo grupet e ndryshme fetare? (Shikoni 1 Korintasve 12:24.)
6. A i thirri Krishti dishepujt e Tij për të krijuar grupe të ndryshme fetare në këtë botë? Ku e bazoni përgjigjen tuaj?
7. A duhet që kishat sot të ndjekin praktikën e kishës së Testamentit të Ri?

8. Pse një kishë që kërkon të jetë kisha e Testamentit të Ri duhet të përdorë për veten e saj emra të gjendur në Testamentin e Ri?
9. A është e mundur të besojmë se duhet të jemi në gjendje ta identifikojmë kishën e Testamentit të Ri dhe të shikojmë se si ndryshon nga ndarjet e sotme fetare?

FJALË NDIHMËSE

Darka e Zotit – është një memorial i krijuar nga Jezusi natën që Ai u tradhtua. Kisha e Testamentit të Ri e merr këtë darkë çdo ditë të parë të javës (të dielën). Kjo darkë konsiston në ngrënien e bukës së paardhur (pa maja) dhe në të pirën e frutit të vreshtit. (Shikoni 1 Korintasve 11:20, 23–26.)

muzikë me instrumente – këngë të kënduara me shoqërimin e instrumentave muzikorë, si me tambure, kitarë, piano, organo apo vegla frymore. Një muzikë e tillë nuk përmendet në Testamentin e Ri në lidhje me adhurimin në kishë. Kisha e Krishtit këndon dhe bën melodi me zemër (Efesianëve 5:19).

ndarje fetare – një grup bashkësish fetare me një emër të caktuar që nuk gjendet në Bibël, të bashkuar nën një grup të caktuar besimesh dhe të qeverisur nga një lloj këshilli. *Meqënëse asnjë ndarje fetare nuk gjendet në Testamentin e Ri, atëherë kjo nuk është një frazë nga Bibla.*

protestant – emri i dhënë grupeve fetare të krijuara nga njerëzit, besimi dhe praktika e të cilëve janë bazuar në parimet e Reformimit Protestant. Udhëheqësit e kësaj lëvizje «protestuan» kundër disa praktikave të kishës katolike romake (si të ushtruarit e autoritetit të papëve dhe priftërinjve, etj). Megjithëse kjo lëvizje luftoi shumë gabime të kishës katolike, ajo nuk u përpoq të rikthehej te kisha e Testamentit të Ri. Kisha e Testamentit të Ri e bazon aktivitetin e saj vetëm në zbatimin e Fjalës së Perëndisë, jo në ndreqjen e praktikave të gabuara të të tjerëve.

(të) vjetrit – (apo të quajtur ndryshe «pleqtë») burra kristianë të pjekur të cilët janë zgjedhur për t’u kujdesur për bashkësinë lokale (1 Timoteut 3:1–7).

KISHA E TESTAMENTIT TË RI		
THEMELUESI: KRISHTI Mateu 16:18	VENDI: JERUZALEM Isaia 2:3; Veprat 2:5, 47	KOHA: 33 e. s. Veprat 2
ORGANIZIMI Filipianëve 1:1	TË VJETRIT: Tit. 1:5; 1 Pj. 5:1-3; Vep. 20:28; 1 Tim. 3:1-7; DHJAKËT: Vep. 6:1-6;	
EMRAT PËR KISHËN Efesianëve 3:15	KISHA: Kol. 1:18, 24; TRUPI I KRISHTIT: Ef. 1:22-23; MBRETËRIA: Vep. 8:12; KISHAT E KRISHTIT: Rom. 16:16; KISHA E PERËNDISË: 1 Kor. 1:2; Vep. 20:28; FAMILJA E PERËNDISË: Ef. 2:19; 1 Tim. 3:15; NDJEKËSIT E ZOTIT: Vep. 9:1; TEMPULLI I PERËNDISË: 1 Kor. 3:16; KISHA E TË PARËLINDURIT:	
EMRAT PËR KRISTIANËT Efesianëve 3:15	DISHEPUJ: Vep. 11:26; SHENJTORË: 1 Kor. 1:2; Fil. 1:1; FËMIJË TË PERËNDISË: Gal. 3:26; 1 Gjo. 2:1; VËLLEZËR: Llu 8:21; Gal. 6:1; KRISTIANË: Vep. 11:26, 26:28;	
BESIMI	JEZU KRISHTI: Mt. 16:16-18; Vep. 8:37	
FJALA E PERËNDISË: BAZA E BESIMIT DHE	GJITHË FUQIA: Mt. 28:18-20; Rom. 1:16; Heb. 4:12; QEVERISJA E KISHËS: 2 Tim. 3:16-17; 2 Pj. 1:3; FARA E MBRETËRISË: Mt. 13:3; Llu. 8:11; SHPATA E FRYMËS: Ef. 6:17	
ADHURIMI	TË KËNDUARIT: Kol. 3:16; LUTJA: 1 The. 5:17; MËSIMI: Vep. 20:7; DARKA E ZOTIT: Vep. 20:7; 1 Kor. 11:23; KONTRIBUTI: 1 Kor. 16:1-2	
MISIONI	SHPËTIMI I SHPIRTRAVE: Mt. 28:18-20; Gjo. 6:45; Ef. 3:10; 1 Tim. 4:16	
PARALAJMËRIMI	QËNDRO NË TË VËRTETËN: Gal. 1:6-8; Mt. 15:9, 13; 2 Kor. 11:3; Zbu. 22:18-19; 2 Gjo. 9	

Autor: *Eddi Cloer*

Marrë nga libri: "Si të bëhesh një kristian besnik"

© 2002 E VERTETA PER SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara